



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCES



100 Vjet Pavarësi

FTESË PËR KONSULTIM PUBLIK

Mbi kërkesën për konsultë në lidhje me përjashtimin nga detyrimi për njoftim të marrëveshjes në tregun e detergjentëve(rasti Cosmodet)

Përfaqësuesi i autorizuar ligjor të shoqatës “Kozmodet” ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës një kërkesë në lidhje me përjashtimin nga detyrimi për njoftim i një marrëveshje në tregun e detergjentëve.

Kozmodet është një shoqatë biznesi e krijuar në Serbi në të cilën janë antarësuar shoqëri që operojnë në sektorin e prodhimit, shpërndarjes dhe shitjes së produkteve kozmetike e detergjentëve.

Në datën 16 Korrik 2012 Bordi drejtues i Kozmodet ka marrë një Vendim për të zhvilluar dhe zbatuar Projektin PREP-P-ËB në vendet e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht: Shqipëri, Bosnjë, Maqedoni, Mali Zi, Serbi dhe Kosovë, me qëllim prezantimin e një kategorie të re produktesh në tregun e rajonit. Ky projekt është miratuar nga A.I.S.E. (Shoqata Ndërkombëtare e Sapunëve, Detergjentëve dhe produkteve të Mirëmbajtjes) në të cilën Kozmodet është e anëtarësuar.

Projekti është i hapur për të gjitha shoqërit e rajonit të cilat operojnë në tregun e prodhimit dhe shitjes së detergjentëve pluhur për larjen e rrobave në tregun Shqiptar, atë të Bosnjës, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës.

Tregu përkatës i produktit që preket nga ky projekt është ai i prodhimit dhe shitjes me shumicë të detergjentëve larës.

Tregu përkatës gjeografik shtrihet në vendet e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht: Shqipëri, Bosnjë, Maqedoni, Mali Zi, Serbi dhe Kosovë (Rajoni).

Pjesëmarrësit e parë në këtë Projekt janë tre shoqërit:

- Henkel Srbija d.o.o. Beograd, Serbi;
- Beohemija d.o.o. Beograd, Serbi;

- Procter and Gamble International Operations SA, Gjenevë, Zvicër me anë të filialit të saj në Serbi.

Projekti do të lançohet 10 muaj pas depozitimit të kërkesës për përjashtim pranë Autoriteteve përkatëse të Konkurrencës në vendet ku do të shtrihet projekti dhe do të zgjasë për një periudhë 1 (një) vjecare.

Qëllimi i Projektit:

Projekti, për zhvillimin dhe zbatimin e të cilit është marrë Vendimi i Shoqatës Kozmoted, *ka të bëjë me prezantimin dhe reklamimin e përbashkët në tregjet e rajonit të kategorisë së produktit të njohur si “detergjent kompakt për larjen e rrobave” dhe konkretisht me prezantimin e një standarti të ri në treg, i cili synon të zvogëlojë sasinë e detergjentit pluhur të nevojshëm për një cikël larjeje deri në një maksimum prej 100g, me qëllim ofrimin e një numri të madh kursimesh ekologjike dhe avantazhesh për mjedisin.*

Pavarësisht standartit të ri, i cili mund të përqafohet nga të gjithë prodhuesit e detergjentëve në rajon (me anë të Projektit ose jo), ***nuk kemi të bëjmë me një produkt të njëjtë, por vetëm me një standart të njëjtë, pasi Formula e produkteve të reja do të zhvillohet në mënyrë të vecantë dhe individuale nga të gjitha shoqëritë që do të jenë pjesëmarrëse në këtë Projekt, duke bërë që secili produkt i ri të ketë karakteristika të ndryshme të cilat do të varen nga formula prodhuese dhe strategjia e secilit prodhues më vete.***

Me anë të këtij Vendimi Kozmoted synon: *të shpërndajë riskun e zhvillimit dhe prezantimit të një produkti të ri midis Pjesëmarrësve, efikasitetin në lidhje me fushatat promovuese, rritjen e interesit në Projekt duke afruar shoqëri të reja, rritjen e cilësisë së Projektit, hedhjen në treg të produktit të ri sa më shpejt që të jetë e mundur, si dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të ndryshuar mënyrën e përdorimit të produkteve, nëpërmjet fushatave të përbashkëta të komunikimit dhe edukimit të konsumatorit.*

Vendimi përcakton elementët kryesor të edukimit të përdoruesve të detergjentëve nëpërmjet fushatës, si dhe kërkesat dhe përmirësimet kryesore që produkti duhet të ketë për një zhvillim të qëndrueshëm¹.

Çdo pjesëmarrës mund të ketë nevojë për disa investime në drejtim të pajisjeve, zhvillimit të formulës së re, fushatës publicitare etj, megjithatë shoqëritë pjesëmarrëse do të kenë parasysh efektet pozitive të reklamimit dhe fushatës së marketingut në nivelin e industrisë si një e tërë.

¹ Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton një zhvillim i cili garanton një cilësi më të mirë jetese për të gjithë ne tani dhe për brezat që do të vinë.

Kostot e fushtës do të jenë në ngarkim të vetë pjesëmarrësve, por do të administrohen nga Kozmoted me anë të një buxheti të veçant të krijuar për këtë qëllim.

Shoqëritë pjesëmarrëse do të angazhohen veçanërisht në:

- *Zhvillimin dhe hedhjen në treg të formulave optimale të cilat do t'ju mundësojnë konsumatorëve të arrijnë të njëjtat rezultate por me dozazh më të ulët;*

Konkretisht Shoqëritë pjesëmarrëse duhet të garantojnë se të gjithë detergjentët e tyre pluhur për larjen e rrobave (dhe “variantet” e tyre), në një shtet të dhënë, të kenë një dozim të rekomanduar jo më të madh se 100g/larje dhe maksimumi 155 ml/larje për një makinë larëse me ngarkesë standarte me rroba “jo shumë të pista” që do të lahen në ujë me rëndesë mesatare.

- *Komunikimin e hapur me konsumatorët rreth mënyrës se si arrihet përmirësimi i synuar i qëndrueshmërisë duke inkurajuar përdorimin e saktë të produkteve të reja.*

Hapat e mësipërme do të zbatohen nga shoqëritë paralelisht duke garantuar se detergjentët e hedhur në treg janë të sigurt për njeriun dhe mjedisin duke bërë vlerësimin e riskut.

Detergjentët kompakt larës ekzistojnë prej kohësh në Europën Qëndrore dhe Perëndimore ku dozazhi i rekomanduar për një cikël larjeje është midis 85 dhe 90 gramë për detergjent.

Avantazhet e Projektit:

Prezantimi i standartit të ri/kategorisë së re të produktit ka për qëllim të ofrojë:

- Ndikim më të vogël në mjedis të sektorit të detergjentëve për larjen e rrobave, duke promovuar dhe inkurajuar pakësimin e kimikateve, materialeve paketuuese dhe kursimin e energjisë në nivelet e prodhimit dhe shpërndarjes së detergjentëve kompakt.
- Inkurajim të konsumatorit për të ndryshuar mënyrën e përdorimit të produkteve, përmes fushatës së komunikimit me konsumatorët.

Sipas standartit të ri pjesëmarrësit e Projektit duhet të zhvillojnë secili më vete një formulë që synon pakësimin e peshës dhe sasisë së detergjentit larës. Detergjenti më standarte të reja do të mundësojë larjen e rrobave me cilësi të njëjtë duke ruajtur një mjedis të pastër, pasi do të prodhojë më pak mbejte shtëpiake.

Fushata do të promovojë avantazhet e vetë Projektit, ato të zhvillimit të qëndrueshëm të produktit, mbrojtjes së mjedisit si dhe përgjegjësinë sociale të pjesëmarrësve të Projektit.

Qëndrimi i Kozmoted:

Vendimi i Kozmoted ka të bëjë vetëm me zhvillimin dhe marketimin e detergjentëve kompakt larës në rajon në kuadër të Projektit. Kozmoted mendon se Vendimi dhe Projekti nuk shkaktojnë asnjë efekt negativ në konkurrencën e tregut përkatës së detergjentëve për larjen e rrobave për sa kohë qëllimet e tyre janë të kufizuara në *“krijimin e një plani të përgjithshëm për zhvillimin dhe hedhjen në treg të një formule optimale e cila do t’u mundësojë konsumatorëve të arrijnë të njëjtat rezultate në larjen e rrobave, por me dozazh me të ulët”*.

Kjo fushatë nuk do të promovojë një markë të caktuar, por Kozmoted do të krijojë një logo të re dalluese e cila nuk do të zëvendësojë markën e produktit të një shoqërie të caktuar, por do të përdoret krahas saj. Kjo do të ndihmojë konsumatorin dhe shoqëritë tregtare të dallojnë më lehtë detergjentët e rinj që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e detergjentëve.

Prezantimi i standartit të ri nuk ndërhyr dhe nuk prek konkurrencën mes pjesëmarrësve në treg të cilët nga ana tjetër do të vazhdojnë të konkurrojnë në çmim, cilësi, kosto prodhimi dhe marketing. Kozmoted ka lidhur Marrëveshje Konfidencialiteti me të gjithë pjesëmarrësit e cila ndalon shkëmbimin e informacionit midis Pjesëmarrësve.

Kozmoted shprehet se Vendimi dhe Projekti nuk ka për qëllim dhe as pasojë kufizimin, ndalimin apo cënimin e konkurrencës në Rajon dhe Shqipëri. Qëllimi i këtij Vendimi (ndarja e riskut, kostove të marketingut, edukimi i përbashkët i konsumatorit dhe prezantimi i kategorisë së re të produktit në treg) nuk mund të arrihet vecse nëpërmjet Projektit dhe inisiativës së Kozmoted.

.....

Përpara dhënies së një vendimi lidhur me aplikimin e Cosmodet, Autoriteti i Konkurrencës do të zhvillojë një takim konsultativ me palët e interesuara dhe palët e treta lidhur me këtë projekt dhe për këtë arsye fton palët e interesuara, shoqatat e biznesit, prodhuesit dhe/ose importuesit e detergjentëve, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit dhe palët e treta të shprehin mendimet e tyre në adresën e Autoritetit të Konkurrencës:

Adresa postare: Autoriteti i Konkurrencës, rr.Sami Frashëri, nr.4/kati IV,Tiranë;

Adresa elektronike: competition@caa.gov.al

Tel/fax: 04 2234504/ 042234497